

Transoilgroup sh.a

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2017**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM	5
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE	5
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE (VAZHDIM)	6
3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME	7
4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË	12
5. INVENTARI	12
6. LLOGARITË E ARKËTUESHME	12
7. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALËT E LIDHURA	12
8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA	12
9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	13
10. DETYRIMET AFATAGJATA	14
11. HUAMARRJET	14
12. LLOGARITË E PAGUESHME	15
13. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA	15
14. KAPITALI AKSIONAR	15
15. TË ARDHURAT	15
16. TË ARDHURA TË TJERA	15
17. SHPENZIMET PËR MATERIALE	16
18. SHPENZIME PERSONELI	16
19. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE	16
20. SHPENZIMI PËR PPE dhe PPA	17
21. SHPENZIME TË TJERA	17
22. TË ARDHURA FINANCIARE	17
23. SHPENZIMET FINANCIARE	17
24. TATIM FITIMI	18
25. PALËT E LIDHURA	19
26. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË	19
27. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT	19

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Tranoilgroup sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Tranoilgroup sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, si dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjëstë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.6 të pasqyrave financiare ku shpjegohet ndikimi negativ nga rënia e çmimit të naftës dhe gjykimin e drejtimit dhe hapave të ndërmarra për të mbuluar detyrimet financiare si dhe për të përmbushur angazhimet e saj investuese të kërkuara nga kontrata e konçesionit. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të dhe për ato kontrole të brendshme që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, priten që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Transoilgroup sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega Shqipëri



30 mars 2018
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar



Transoilgroup sh.a

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	
Aktive afatgjata materiale	9	3.394.612	3.452.095
Totali i aktiveve afatgjata		3.394.612	3.452.095
Inventari	5	209.790	114.216
Llogari të arkëtueshme	6	4.800	3.757
TVSH e arkëtueshme		2.143	860
Te arkëtueshme nga palët e lidhura	7	353.888	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	28.402	11.370
Mjete monetare dhe depozita afatshkurtra	4	8.258	41.816
Totali i aktiveve afatshkurtra		607.281	172.018
TOTALI AKTIVEVE		4.001.893	3.624.113
Kapitali aksionar	14	10.000	10.000
Humbje e akumuluar		(1.998.562)	(2.759.122)
Totali i kapitalit aksionar		(1.988.562)	(2.749.122)
Detyrime afatgjata	10	37.121	136.988
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	25	2.488.948	2.655.750
Huamarrje afatgjata	11	2.205.281	2.438.572
Totali i detyrimeve afatgjata		4.731.350	5.231.309
Llogari të pagueshme	12	202.538	239.692
Llogari të pagueshme të tjera	13	183.206	181.887
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	25	511.655	561.872
Huamarrje afatshkurtra	11	361.706	158.475
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1.259.105	1.141.926
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONAR		4.001.893	3.624.113

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë më 29 mars 2018.

Av. Shefqet Dizdari

Administratori

Bernard Sylaj

Shef Kontabiliteti

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E PERFORMANCËS Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shitjet	15	360.943	601.495
Renta minerare		(36.093)	(60.150)
Të ardhura të tjera	16	181.186	32.528
Të ardhurat neto		506.034	573.873
Shpenzimet për materiale	17	(195.758)	(196.509)
Ndryshimi i gjendjes së inventarit		89.034	(42.282)
Shpenzimet e personelit	18	(137.296)	(121.173)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	19	(167.181)	(167,537)
Shpenzime për PPE dhe PPA	20	9.941	(107.281)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9	(88.762)	(80.996)
Shpenzime të tjera	21	(11.502)	(20.560)
Provizione	26	-	(134.343)
Fitim (humbje) nga veprimtaria operative		4.510	(296.808)
Të ardhura financiare	22	788.415	1.828
Shpenzime financiare	23	(32.365)	(123.025)
Fitimi (humbja) para tatimit		760.560	(418.005)
Tatim fitimi	24	-	-
Fitimi (humbja) neto		760.560	(418.005)

Pasqyra e performancës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mije Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Humbje e akumuluar	Totali
Më 1 janar 2016	10.000	(2.341.117)	(2.331.117)
Humbja neto për vitin	-	(418.005)	(418.005)
Më 31 dhjetor 2016	10.000	(2.759.122)	(2.749.122)
Fitimi neto për vitin	-	760.560	760.560
Më 31 dhjetor 2017	10.000	(1.998.562)	(1.988.562)

Pasqyra financiare e ndryshimeve në capital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi (humbja) neto para tatimit	760.560	(418.005)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimet dhe amortizimet	9 88.762	80.996
Provizione afatshkurtër Albpetrol	12 147.091	157.032
Efeki i luhatjeve të kursit të këmbimit të huasë	(339.945)	46.453
Fitim/ (humbje) nga shitja e aktiveve afatgjata	(1.159)	229
Fitimi/ (humbja) operative përpara rregullimeve në kapitalin punues	655.308	(179.748)
(Rritja)/ rënia në llogaritë të arkëtueshme	6 (373.247)	206.647
(Rritja)/ rënia në inventar	5 (95.574)	42.837
(Rënia)/ rritja në llogarite e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	12,13 (282.793)	23.149
(Rënia)/ rritja në llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura	23 (217.018)	6.739
Fluksi monetar i gjeneruar nga veprimtaria e shfrytëzimit	(968.632)	279.372
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit		
Blerje aktive afatgjata materiale	9 (32.047)	(152.942)
Nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata	1.926	(229)
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë e investimit	(30.121)	(153.171)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit		
Hua të marra	309.887	39.158
Fluksi monetar neto në veprimtaritë e financimit	309.887	39.159
Rënia neto në mjete monetare dhe ekuivalentë	4 (33.558)	(14.389)
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 1 janar	41.816	9.752
Efeki i luhatjeve të kursit të këmbimit	-	-
Mjete monetare dhe të tjera më 31 dhjetor	8.258	41.816

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

Transoilgroup sh.a ("Shoqëria") është themeluar më 22 nëntor 2011 sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me qendër në Tiranë. Shoqëria ka filluar aktivitetin gjatë vitit 2012 dhe nuk ka veprimtari të mëparshme. Që nga shkurti i 2012 Shoqëria është përfshirë në operacionet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri.

Shoqëria operon në Shqipëri në zonën naftëmbajtëse të Visokes sipas Marrëveshjes Hidrokarbure të Shoqërisë të mëmë Transoilgroup AG (Zvicër) dhe Albpetrol sh.a (Albpetrol), shoqëri në pronësi shtetërore nën licencën ekzistuese të Albpetrol me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Marrëveshja e Visokës u bë efektive në dhjetor 2008 dhe ka një kohëzgjatje prej 25 vitesh me mundësinë e zgjatjes së afatit, me kërkesë të Shoqërisë dhe aprovimin nga qeveria dhe entet regullatore.

Shoqëria më 31 dhjetor 2017 kishte të punësuar 132 punonjës (31 dhjetor 2016: 136 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Baza e përgatitjes

Paqyrat financiare janë përgatitur sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit Shqipëtar (SKK).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek.

Kurset zyrtare të këmbimit të monedhave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të publikuara nga Banka e Shqipërisë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
USD / LEK	111.10	128.17
EURO / LEK	132.95	135.23

2.4 Periudha krahasuese

Për prezantimin më konsistent të transaksioneve, klasifikimi i zërave të caktuar në informacionin financiar krahasues është ndryshuar për të qenë në përputhje me trajtimin e vitit aktual. Riklasifikimet janë bërë si mëposhtë:

- Të ardhura të tjera (shënim 17) për të ardhurat e gjeneruara nga qeraja dhe të ardhura nga uji teknologjik është riklasifikuar nga shpenzime të tjera, neto (shënim 22).
- Shpenzimet per PPE dhe PPA (shënimi 21) për njohjen e shpenzimit të vitit për detyrimin ndaj Albpetrolit është riklasifikuar nga shpenzime të përgjithshme dhe administrative (shënim 20).

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe raportimin e shumave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e nënvizuara rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e aktiviteteve të realizuara nga Shoqëria.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE (VAZHDIM)

2.6 Vijueshmëria

Shoqëria është operatori në emër të Shoqërisë të saj mëmë, Transoilgroup AG, për Licence Marrëveshjen me Ndarje Prodhimi të naftës ("MNP") midis Transoilgroup AG dhe Albpetrol sh.a, shoqëria shtetërore e naftës. Sipas kushteve të MNP, është e nevojshme që Shoqëria dhe Shoqëria mëmë të bejnë shpenzime kapitale në fushën e naftës të cilat aprohen nga AKBN dhe Albpetrol cdo vit financiar. Investimi ka për qëllim për të përmirësuar pajisjet dhe infrastrukturën ekzistuese, shpimin e puseve të reja dhe rritjen e prodhimit të naftës së papërpunuar në nivele të qëndrueshme tregtare.

Më 18 dhjetor 2017, aksionarët e Shoqërisë, AKBN dhe Albpetrol mbajtën Takimin e Këshillit ku u ra dakord për planin e investimeve të Shoqërisë për vitin 2018. Gjate takimit u parashikuan dy skenarë në lidhje me investimet që parashikojmë të kryhen:

- Skenari i pare; Nëse çmimi në treg do të jetë poshtë 70\$/Bbl parashikohen disa ndërhyrje vitale dhe testime në puse ekzistuese dhe rivenien në pune nga fondi i ndalur, të cilat do të mundësonin shtimin e prodhimit sipas metodave alternative dhe të reja. Vlera e investimit e parashikuar në këtë skenar do të jetë deri në 5 milionë USD.
- Skenari i dytë; Nëse çmimi do të jetë mbi 70\$ dhe do të tregojë qëndrueshmeri në këto nivele, atëherë parashikohet kryerja e një investimi në rreth 14 milionë USD, ku përfshihet shpimi i 10 puseve të reja.

Por për ta theksuar, realizimi i këtij projekcioni për skenarin e dytë është shumë i varur nga mjedisi ekonomik dhe financiar, në të cilin do të operohet. Nëse çmimi i shitjes (mesatar i ponderuar) nuk ngrihet mbi 70\$/Bbl, realizimi i projekteve të investimeve të parashikuara për këto skenar kthehet në pamundur për t'u realizuar, për shkak të defiçitit shumë të madh që krijohet në Cash Flow-n operacionale.

Me nivelin aktual të prodhimit nga pusët ekzistuese dhe me çmimin Brent prej rreth USD 66.87/bbl (31 dhjetor 2016 USD 52/bbl), duke konsideruar dhe një rritje të Brent-it me rreth 25% drejtimi i Shoqërisë vlerëson se do të ketë të hyra të mjaftueshme të mjeteve monetare për të përmbushur kërkesat e saj monetare, si dhe detyrimet në natyrë (naftë) ndaj Porto Romano Oli sh.a.

Gjate tremujorit të parë të vitit 2018 Shoqëria ka angazhuar tre kompani të huaja të cilat po testojnë disa metoda alternative për të rritur prodhimin e puseve aktuale. Sipas parashikimeve të deritanishme pritet që prodhimi të rritet me rreth 20% krahasuar me nivelin aktual të nxjerrjes.

Për të administruar situatën e likuditetit, janë në fuqi dhe masat e mëposhtme:

- Porto Romano Oil ka nënshkruar si borxh të varur të gjitha pretendimet e saj aktuale dhe të ardhshme për dërgesa tretësi (Kërkesat Vartëse) kundër Transoilgroup sh.a duke ju dhënë përparësi shlyerjes së të gjitha borxheve të tjera aktuale ose të ardhshme të Transoilgroup sh.a ndaj të gjithë kreditorëve të tjerë.
- Të gjitha detyrimet e Shoqërisë mëmë drejt Bordit të Drejtorëve dhe Aksionerët kanë qenë gjithashtu në vartësi dhe operacionet me selinë janë riorganizuar në mënyrë për të reduktuar ndjeshëm kostot.

Si rezultat i këtyre veprimeve, Drejtimi beson se nuk ka rrisje materiale për Transoilgroup sh.a. për të mos përmbushur detyrimet e tij operacionale të pakten për një periudhë 12 muajore nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave dhe se supozimi i vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare është i përshtatshëm.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve ku specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga këmbimi për zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës.

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, huamarrje, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Shoqëria nuk ka instrumenta financiarë derivativë. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, përveç instrumentave jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrje

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Të tjerë

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e përlllogaritur për mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme, huamarrjeve, duke zbritur cdo rënie në vlerë, përafrohet me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.3 Aktivet Afatgjata Materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga ku aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen për vlerën neto në pasqyrën e performancës.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve fikse në aktivitetet e prodhimit të hidrokarbureve llogaritet duke përdorur metodën e njësisë-së-prodhimit duke iu referuar përqindjes së prodhimit në vit e lidhur me rezervat e vërtetuara dhe të mundshme, përveç në rastin e aktiveve, jeta e dobishme e të cilave është më e shkurtër se jeta e fushës, në të cilin rast metoda lineare është aplikuar.

Për aktivet të tjera, amortizimi është njohur në pasqyrën e performancës duke përdorur metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar për çdo pjesë të aktiveve materiale afatgjata. Toka nuk amortizohet. Vlerësimi i jetës së dobishme, vlerës së mbetur dhe metodës së amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, me efektin e ndonjë ndryshimi të llogaritit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat respektive të amortizimit janë si më poshtë: Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese.

Kategoritë kryesore të aktiveve fikse amortizohen me metodën lineare duke përdorur jetët e dobishme të mëposhtme:

Përmirësimet e objekteve me qera	më e vogla mes kohëzgjatjes së qerasë dhe jetës së dobishme
Mobilje dhe instalime	5-10 vite
Pajisje informatike dhe zyre	3-5 vite
Makineri	5-8 vite

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.4 Inventari

Inventarët vlerësohen me vlerën më të ulët midis kostos mesatare të prodhimit dhe vlerës neto të realizueshme.

Kostoja përfshin të gjitha kostot e ndodhura në një situatë normale biznesi për sjelljen e inventarëve në vendodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e naftës së papërpunuara është kostoja e blerjes ose kostoja e prodhimit, duke përfshirë pjesën e zhvlerësimit, firos dhe amortizimit dhe të përgjithshme bazuar në kapacitetin normal. Kostoja llogaritet në bazën e peshës mesatare të kostove të inventarit mbi prodhimin e vitit.

Vlera neto e realizueshme bazohet në vlerësimin e cmimit të shitjes gjatë aktivitetit normal të biznesit duke zbritur kostot e vlerësuar për kompletimin dhe përfundimit e shitjes.

3.5 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar është konsideruar i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një apo më shumë ngjarje kanë pasur një efekt negativ mbi flukset monetare të ardhshme të atij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si ndryshim midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuar që janë skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi ose njësive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

3.6 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin e një shume dhe kohëzgjatje të pasigurt. Provizionet nuk njihen për humbje operative të së ardhmes.

3.7 Kostot e çmontimit

Si pasojë e natyrës së aktivitetit, Shoqëria ka impakt në mjedis. Shoqëria synon të ndjekë praktikën më të mira për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure, Shoqëria duhet që në fund të koncesionit të kthejë mjedisin në gjendjen e tij mëparshme. Drejtimi ka konkluduar se Shoqëria ka detyrim për të çmontuar vetëm makineritë dhe pajisjet të vendosura pas datës së marrjes në dorëzim të zonës naftëmbajtëse dhe jo të pajisjeve që kanë qenë paraprakisht të vendosura. Detyrimi për çmontim matet me vlerën aktuale të vlerësimit më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer detyrimin në datën e bilancit.

Sipas Licencë Marrëveshjes me Ndarje Prodhimit, seksioni 3.9, Shoqëria duhet të paraqesë tek AKBN 5 vite para përfundimit të Licence Marrëveshjes një plan të detajuar mbi abandonimin e fushes për miratim nga AKBN.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.8 Detyrimet të ripagëshme në natyrë

Detyrimet e pagueshme në natyrë mund kryhet në dy mënyra. Shoqëria mund të marri hua inventarë nga një palë tjetër si psh, Albpetrol ose të dorëzojë më pak naftë të papërpunuar tek Albpetrol sesa është e përcaktuar në Marrëveshjen e Hidrokarbureve. Bazuar në prodhim, ka dy lloj sasive naftë të papërpunuar të detyrueshme ndaj Albpetrolit:

- Sipas Marrëveshjeve Hidrokarbure Shoqëria do të dorëzojë në natyrë Albpetrolit *Prodhimin Paraekzistues* ("PPE") të puseve të marra në dorëzim nga Shoqëria. PPE do të jetë 70% e mesatares së prodhimit të naftës bruto të cdo pusi në 6 muaj kalendari para muajit në të cilën është bërë marrja, dhe rënie cdo muaj pas marrjes mbi bazën e një rënie prodhimi eksponencial prej 10% në vit.
- *Nafta e disponueshme* do të ndahet më tej ndërmjet Albpetrolit ("*Pjesa e Prodhimit të Albpetrolit-PPA*") dhe Shoqërisë ("*Nafta per Mbulimin e Kostove*") bazuar në faktorin R sic përcaktohet në Marrëveshjen Hidrokarbure. Pasi Shoqëria ka mbuluar të gjitha Kostot Hidrokarbure të saj nga *Nafta per Mbulim të Kostove*, nafta e mbetur do të njihet si *Naftë fitim*.

Detyrimet në natyrë njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Detyrimet vlerësohen me më të voglën midis vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë në datën e raportimit kundrejt njohjes fillestare. Vlera e drejtë përcaktohet duke vlerësuar sasinë e naftës në natyrë me çmimin e naftës Brent rregulluar për ndryshimin sipas cilësisë së naftës bruto.

Për detyrimet ku Shoqëria është e detyruar t'i shlyejë në mjete monetare, në cdo datë raportimi detyrimet vlerësohen me vlerën e drejtë duke marrë parasysh ndryshimet në vlerën e drejtë të paraqitura në pasqyrën e performancës. Për detyrimet që duhet të shlyhen në natyrë, në fund të vitit sasia e naftës e pa terhequr nga Albpetrol vlerësohen me Brent dhe humbjet ose fitimet regjistrohen në ndryshimin e gjendjes së inventarit.

3.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë aktivitetit normal maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose llogarive të arkëtueshme neto nga zbritjet dhe nga taksat e lidhura me shitjet. Të ardhurat nga shitja e naftës të papërpunuar regjistrohen kur rreziqet dhe përfitimet mbi pronësinë të produktit i transferohen blerësit, që ndodh kur të drejtat ligjore i kalojnë palës tjetër.

3.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë të ardhura apo shpenzime nga interesi dhe komisione bankare dhe humbje ose fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare njihen kur ato ndodhin. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes (nqs ekzistojnë) dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejtë në pasqyrën e performancës.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Bazuar në ligjin shqiptar si dhe në Marrëveshjen e Hidrokarbureve, Shoqëria, është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në normën 50%. Baza e tatueshme është "Fitimi nga Nafta" e cila është e përcaktuar sipas mekanizmit të faktorit R. Hidrokarburi i përfituar është pjesa e mbetur e sasisë totale të hidrokarburit të prodhuar në një periudhë të përcaktuar pasi është zbritur kostoja e hidrokarburit, e cila është pjesa e hidrokarburit të prodhuar që kontraktori ka të drejtë të përdorë për të mbuluar kostot e kapitalit dhe shpenzimeve operative, duke përfshirë 10% taksë minerare mbi të ardhurat nga shitja. Shpenzimet e interesit, dhurimet, gjobat, shpërblimet, shpenzimet e shpërndarja nga zyra qendrore që kalojnë përtej shumës së përcaktuar nga Marrëveshja e Përbashkët të Prodhimit, dhe shpenzime të tjera të paarsyeshme dhe të panevojshme për operacionet e hidrokarbureve janë të pa rikuperueshme. Shpenzimet e akumuluar gjatë fazës së kërkimit dhe zhvillimit janë totalisht të rikuperueshme pa qënë objekt i zhvlerësimit.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Kostot e përfundimit dhe restaurimit janë plotësisht të rikuperueshme me miratimin e vlerësimit nga AKBN, kostot e vlerësuara të përfundimit do të përfshihen në Kostot e Hidrokarbureve dhe mbulohen sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve dhe në kohën e dhënë në vlerësim.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË

Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
<i>Arka</i>		
Mjete monetare në LEK	149	92
	149	92
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse në LEK	7.981	41.400
Llogari rrjedhëse në EUR	-	266
Llogari rrjedhëse në USD	121	55
Llogari rrjedhëse në CHF	7	3
	8.109	41.724
	8.258	41.816

5. INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Naftë e papërpunuar	177.816	88.783
Materiale të tjera	28.142	22.882
Lënda tretëse	3.832	2.551
	209.790	114.216

Materiale të tjera përfshijnë materiale konsumi dhe pjesë këmbimi që nevojiten gjatë procesit të nxjerrjes dhe inventarizimit të naftës së papërpunuar, si dhe materiale të tjera ndihmëse.

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të përbëra si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Evadim uji teknologjik	2.271	1.113
Naftë e papërpunuar	748	863
Te arkëtueshme të tjera	1.781	1.781
	4.800	3.757

Më 31 dhjetor 2017 llogaritë e arkëtueshme vijnë nga shitjet e naftës së papërpunuar drejt klienteve dhe për shërbimin e evadimit të ujit teknologjik. Te arkëtueshme të tjera lidhen me shitje të disa pajisje naftë.

7. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALËT E LIDHURA

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është e përbërë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Portoromano Oil sha	338.748	-
Albdrilling sha	15.140	-
	353.888	-

Gjate vitit 2016 Shoqëria ka arritur në një marrëveshje të netimit të detyrimit dhe të drejtave respektive me palët e lidhura si furnitor dhe klient, respektivisht me Porto Roman Oil sh.a për furnizim me hollues dhe blerjen e naftës së papërpunuar, Albdrilling sh.a si nënkontraktori i shpimeve horizontale dhe blersit i shërbimeve për injektimin e ujit teknologjik në puse. Në 2017 nuk ka marrëveshje netimi.

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzimet e parapaguara ndaj furnitorëve	23.027	10.995
Akciza	5.375	375
	28.402	11.370

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	Puset dhe aktive nafte	Mobilje dhe instalime	Pajisje informatike dhe zyre	Makineri	Ndërtime në proces	Të tjera	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2016	3.291.262	6.311	8.318	45.340	162.149	13.349	3.526.729
Shtesa	51.806	-	-	-	101.572	473	153.851
Pakesime	-	-	-	(2.100)	-	-	(2.100)
Transferime	20.766	-	-	-	(20.766)	-	-
Më 31 dhjetor 2016	3.363.834	6.311	8.318	43.240	242.955	13.822	3.678.480
Shtesa	29.676	2.046	-	-	-	325	32.047
Pakesime	-	-	-	(6.050)	-	-	(6.050)
Transferime	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	3.393.510	8.357	8.318	37.190	242.955	14.147	3.704.477
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 janar 2016	109.721	2.889	5.387	27.461	-	1.123	146.581
Shpenzimi i periudhës	69.608	1.262	2.072	7.500	-	553	80.996
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(1.192)	-	-	(1.192)
Më 31 dhjetor 2016	179.329	4.151	7.460	33.769	-	1.676	226.385
Shpenzimi i periudhës	77.943	1.506	858	7.894	-	562	88.762
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(5.282)	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	257.272	5.657	8.318	36.381	-	2.237	315.147
Vlera kontabël neto më							
31 dhjetor 2016	3.184.505	2.160	858	9.471	242.955	12.146	3.452.095
31 dhjetor 2017	3.136.238	2.700	-	809	242.955	11.910	3.394.612

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

10. DETYRIMET AFATAGJATA

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Provizion për pagesë akcize	-	100.599
Detyrimet afatgjata ndaj Albpetrol	37.121	36.389
	37.121	136.988

Në vitin 2016, Drejtimi vendosi të njohë si provizion shumë të pretenduar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganës si detyrim Akcize për holluesin e injektuar. Në vitin 2017, çështja në gjykim nga Gjykata e Apeli u fitua nga Shoqëria, për rrjedhojë provizionin për pagesë akcize u rimor.

Pasi Shoqëria mori në kontroll zonën naftëmbajtëse, disa sasi të inventarit të hidrokarbureve të papërpunuara, të cilat i përkisnin Albpetrol u lanë në magazine dhe në tuba dhe njihen nga Shoqëria si detyrim afatgjatë ndaj Albpetrol sh.a. Kjo sasi do të rikthehet pasi Marrëveshja me Ndarje Prodhimit të mbarojë.

Në vitin 2017 Shoqëria ka përllogaritur të tërë detyrimin ndaj Albpetrol për PPE dhe PPA në ton metrik (MT) (shënimi 14):

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrimet afatshkurter ne MT	5.350	5.826
Detyrimet afatgjata ne MT	1.350	1.350
	6.700	7.176

Detyrimi mund të zgjidhet në naftë bruto ose me para bazuar në çmimin aktual Brent. Gjatë vitit 2017 Shoqërisë i është rritur detyrimi ndaj Albpetrolit pasi ka levruar një sasi prej **4.681,63 MT (2016: 1.659,34 MT)**. Kjo si pasojë e refuzimit për tërheqje të naftës nga Albpetrol për mungesë të kapaciteteve magazinuese nga ana e tyre.

Detyrimi i njohur matet në Brent e cila është më e ulët se Brent. Diferenca e detyrimit i matur në Brent kundrejt shpenzimit të njohur duke përdorur koston e prodhimit të naftës, njihet nën zërin e shpenzimeve të tjera operative të paraqitura në shënimin shpjegues 20.

Në vitin 2017 Shoqëria ka përllogaritur të tërë detyrimin për PPE dhe PPA 6.699,89 ton metrik (MT) (2016: 7.176,30) të matur me çmim në Brent të 31 dhjetor 2017 (shënimi 11, 14), dhe e ka njohur atë si ndryshim gjendje inventari në Pasqyrën e të Performancës.

11. HUAMARRJET

Hua nga palët e lidhura

Më 30 qershor 2014 Shoqëria nënshkroi një marrëveshje huaje pa interes me Transoilgroup AG per USD 19.849.513. Deri me 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka ripaguar USD 868.336. Hua të tjera afatshkurtra janë marrë nga mëma ne shumë USD 440.000 dhe CHF 2.736.000

Qeraja financiare

Në Nëntor të 2015 është celur një marrëveshje qeraje financiare për automjet me interes Euribor 12M+7% minimumi 9.5% e skeduar der në vitin 2018.

Maturimet e detyrimeve afatgjata janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
A: Huate afatshkurtër		
Transoilgroup AG	360.624	157.374
Landeslease sh.a	1.082	1.101
	361.706	158.475
B: Hua afatgjatë		
Transoilgroup AG	2.205.281	2.437.475
Landeslease sh.a	-	1.097
	2.205.281	2.438.572
	2.566.987	2.597.047

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

12. LLOGARITË E PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme janë detyrime pa interes ndaj furnitorëve vendas dhe të huaj dhe janë të vendosura zakonisht në një periudhë që varion nga 30 deri në 180 ditë.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Ndaj furnitorëve	193.656	223.928
Të përlllogaritura për furnitorët	8.882	5.764
	202.538	239.692

13. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Llogari të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrimet afatshkurter ndaj Albpetrol (shenim 11)	147.091	157.032
Ndaj punonjësve	12.721	1.400
Sigurimet shoqerore	1.771	1.533
Tatimi mbi pagat	1.806	1.175
Të tjera të pagueshme	19.817	20.747
	183.206	181.887

14. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksioner fillestar i kontribuar nga aksionerët e Shoqërisë me efekt në vitin 2012 ishte 10.000 mijë Lekë.

	2017 dhe 2016		
	Numri i aksioneve	% Pronësisë	Vlera nominale në LEK '000
Transoilgroup AG - Zvicër	100'000	100%	10.000
	100'000	100%	10.000

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat për fundin e vitit 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen nga shitjet e naftës së papërpunuara në tregun vendas dhe atë të huaj. Klientët e Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbehen tërësisht nga Porto Romano sh.a me 100% (2016: 70%) të shitjeve të përgjithshme.

16. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera për fundin e vitit 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen nga të ardhura nga qeraja dhe të ardhura nga uji teknologjik.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga fitimi i cështjes ligjore	133.966	-
Të ardhura nga qeraja	24.000	12.467
Të ardhura nga shitja e ujit teknologjik	22.061	18.017
Te ardhura nga shitja e aktiveve	1.159	2.044
Të ardhura të tjera	-	2.044
	181.186	30.528

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

17. SHPENZIMET PËR MATERIALE

Shpenzimet për materiale për fundin e vitit 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kostot e lëndës tretëse – injektuar ne puse	80.701	87.894
Energji elektrike	66.424	59.190
Kostot e lëndës tretëse- injektuar ne shtrese	19.903	14.358
Lëndë djegëse	14.360	14.395
Materiale te tjera	9.025	15.320
Shpenzime qeraje	2.574	4.007
Mirëmbajtje dhe riparime – puse	2.771	1.345
	195.758	196.509

Fusha e Visokës ka një viskozitet të lartë të naftës, e cila ka tendencë të çojë në lëvizshmëri të ulët të naftës dhe e bën të vështirë nxjerrjen e saj. Injektimi i tretësit (holluesit) ka qenë metoda kryesore e përdorur për të përmirësuar lëvizshmërinë e naftës. Tretësi i injektuar në shtresë është përdorur për të rritur lëvizshmërinë e naftës dhe për të sjellë naftën në afërsi të puseve, ku një tjetër sasi tretësi është injektuar në tubin e pusit për të lehtësuar nxjerrjen në sipërfaqe të pusit, dhe më pas në objektet e magazinimit.

18. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit për fundin e vitit 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kostot e personelit të administratës	75.471	69.346
Kostot e personelit të prodhimit	61.825	51.827
	137.296	121.173

19. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzime të tjera për fundin e vitit 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime të tjera administrative	55.291	34.985
Shpenzime indirekte menaxhimi	42.219	44.700
Shërbime ruajtje	25.000	25.000
Bonus ndaj Albpetrol (Licence Marrveshjes seksioni 10.2)	10.856	-
Riparimi dhe mirëmbajtje	8.545	8.656
Udhëtime dhe dieta	7.093	33.506
Shpenzime qeraje operative dhe financiare	4.491	4.661
Shpenzime telekomunikacioni	4.285	3.447
Tarifa konsulence	4.245	7.448
Shpenzime uji, gas dhe energji	2.150	2.170
Shpenzime primi sigurie	1.590	2.539
Shpenzime testimi	1.416	425
	167.181	167.637

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

20. SHPENZIMI PËR PPE dhe PPA

Në 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka përlogaritur të tërë shpenzimin për detyrimin për PPE dhe PPA per Albpetrol ne 5.349,79 ton metrik (2016: 5.826,20), në vlerën 9.941 Lek (2016: 107.281 Lek) të matur me çmim në Brent të 31 dhjetor 2017. Ndryshimi I gjendjes se inventarit per PEP dhe PPA ka rezultuar pozitiv dhe eshte njohur në Pasqyrën e Performancës.

21. SHPENZIME TË TJERA

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Taksa lokale	(9.901)	(19.652)
Shpenzime të tjera	(1.601)	(908)
	(11.502)	(20.560)

22. TË ARDHURA FINANCIARE

Humbjet nga kurset e këmbimit, neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	788.415	1.818
Të ardhurat financiare	-	10
	788.415	1.828

23. SHPENZIMET FINANCIARE

Të ardhurat nga interesi, neto për fundin e vitit 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen :

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Humbjet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	32.172	122.785
Shpenzimet e interesit	193	240
	32.365	123.025

Shpenzimet e interesit rezultojnë nga marrja me qera financiare të makinave nga Landeslease sh.a.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

24. TATIM FITIMI

Tatimi mbi fitimin i Shoqërisë llogaritet sipas Ligjit Nr. 7811 datë 12.4.1994, i ndryshuar, "Mbi Miratimin me Ndryshime të Dekretit Nr.782, datë 22.2.1994 – Mbi Sistemin Fiskal në Sektorin e Hidrokarbureve" dhe në përputhje me Licencën, sipas së cilës fitimi i tatueshëm llogaritet duke zbritur të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale të ndodhura gjatë periudhës së zhvillimit dhe prodhimit nga të ardhurat totale me një normë tatimore 50%. Sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, shpenzimet e zbritshme të zhvillimit dhe prodhimit i raportohen AKBN mbi bazë tremujore. Shpenzimet e zbritshme vërtetohen nga AKBN me anë të kontrolleve dhe mund të jenë subjekt i kundërshtimeve. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka një humbje të tatueshme prej 3,587,319 mijë Lekë (2016: 5.759.060 mijë Lekë), e cila mund të mbartet deri në tre periudhat e ardhshme tatimore. Si rrjedhojë, Shoqëria ka reduktuar humbjen e mbartur me 2.397.757 mijë Lekë për periudhën 2012-2013.

Shoqëria ka vendosur të mos rregjistrojë ndonjë aktiv apo detyrim mbi tatimin e shtyrë në pasqyrat e saj financiare.

Balancat tatimore janë njohur si pozicione jashtë bilancit derisa ato të realizohen.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi/(humbja) e periudhës para tatimit	760.560	(418.005)
<i>Plus:</i> Shpenzimet e pazbritshme	100.916	102.116
Provizione (shenim 27)	-	134.343
Shpenzimet PPE+PPA	(9.941)	107.281
Shpenzime kapitale	(32.047)	(151.751)
Fitim/ (humbje) e vitit	819.488	(226.016)
Humbja e mbartur	(5.985.076)	(5.759.060)
Humbja në fund të vitit	(5.165.589)	(5.985.076)

Shpenzimet e pazbritshme janë përgjithësisht shpenzime pa dokumenta mbështetës të duhura për qëllime tatimore.

Në vitin 2017 Shoqëria ka njohur detyrime ndaj Albpetrol për PPE dhe PPA në Brent për shumën 9.941 mijë Lekë (2016: 107.281 mijë Lekë), e cila është shpenzuar gjatë vitit dhe shtohet përsëri duke qene se sipas Marrëveshjes së Ndarjes së Hidrokarbureve konsiderohet shpenzim jo i zbritshëm. Gjatë vitit 2017 Shoqëria ka reduktuar detyrimin e saj duke transferuar sipas PPE dhe PPA pjesën e naftës të Albpetrol dhe duke qënë që këto kosto janë jo të zbritshme, janë shtuar përsëri për qëllime tatimore.

Humbjet tatimore të mbartura përfaqësojnë kosto hidrokarburi të parikuperuar të kryera gjatë viteve të mëparshme. Kthimet tatimore janë të paraqitura çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruar për qëllime tatimore mbeten të provizionuara derisa autoritetet (Albpetrol dhe AKBN) të shqyrtojnë kthimet dhe rregjistrimet e taksapaguesve dhe të lëshojnë një vlerësim final. Nafta e përfutur dhe kostot e parikuperuara janë subjekt i Ligjit të Hidrokarbureve dhe Marrëveshjes së Perbashkët të Hidrokarbureve (Referojuni shënimit 3.11).

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

25. PALËT E LIDHURA

Shoqëria kontrollohet nga Shoqëria mëmë Transoilgroup A.G, Zvicër e cila ka mundësuar fondet e nevojshme për vazhdimësinë e operacioneve të hidrokarbureve. Tabela e mëposhtme paraqet sasinë totale të transaksioneve që janë kryer me palët e lidhura për vitin përkatës financiar.

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në datën e raportimit, llogaritë e pagueshme të mëposhtme ju detyrohen palëve të lidhura:

Detyrime afatshkurter	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpërndarja e kostos dhe shpenzimeve të përgjithshme administrative ndaj Transoilgroup AG	144.571	83.907
Detyrimet e akumuluar nga operatori i mëparshëm	843	843
	145.414	84.750
Detyrime ndaj Bolv-Oil sh.a	250.288	203.314
Detyrime afatgjata ndaj Porto Romano Oil sh.a	1.023.310	1.123.743
Detyrime ndaj Albdrilling sh.a	1.069.936	1.243.942
	2.488.948	2.655.750
Detyrime afatgjata		
Detyrime afatshkurter ndaj Porto Romano Oil sh.a	511.655	561.872
	3.000.603	3.217.621

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata në lidhje me Porto Romano Oil sh.a kanë të bëjnë me tretësin e blerë i cili përdoret në procesin e nxjerrjes së naftës. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje likuidimi me Porto Romano Oil sh.a, në 3 dhjetor 2013, ku 1/3 e pagesës do të kryhet brenda 12 muaj, dhe 2/3 do të kryhet pas 12 muaj nga data marrjes së faturës nga Shoqëria. Pjesa afatgjatë lidhet me 2/3 të shumës, dhe pjesa afatshkurter e paraqitur në shënimin shpjegues 13 lidhet me 1/3 të shumës kundrejt Porto Romano Oil sh.a.

Natyra e marrëdhënies me palët e lidhura

Shoqëria ka hyrë në këto transaksione me palët e lidhura të mësipërme me kushte reciproke për të cilat është rënë dakort.

Termet dhe kushtet e transaksioneve me palët e lidhura

Shitjet dhe blerjet nga palët e lidhura janë kryer sipas cmimit normal të tregut. Balancat e mbetura ende në fund të periudhës janë të pasiguruara, pa pagesë interesi dhe shlyerja ndodh në mjete monetare. Nuk ka asnjë garanci të dhënë ose të marrë ndaj llogarive të pagueshme ose të arkëtueshme me palët e lidhura. Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria nuk ka bërë ndonjë fshirje për borxhe të dyshimta me palët e lidhura (2016: zero). Ky vlerësim ndërmerret cdo vit duke ekzaminuar pozicionin financiar të palëve të lidhura dhe tregun në të cilën palët e lidhura operojnë.

26. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË

Angazhime qeraje

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Brenda një viti	5.963	5.963
Pas një por jo më shumë se 5 vjet	20.470	9.016
Më shumë se 5 vjet	27.059	28.951
	53.492	43.930

Angazhimet lidhen me qerata operative për hapësirat e zyrave dhe qirasë për tokën. Sipas Marrëveshjes të Koncesionit, Shoqëria është e detyruar të aprovojë Planin e Investimit nga AKBN dhe Albpetrol. Shoqëria ka aprovuar planin e Investimit të vitit 2018 më 18 dhjetor 2017 bashke me Albpetrol (shenimi 2.6).

Çështjet ligjore

Gjatë aktivitetit normal, kompania mund të përfshihet në procedime gjyqësore, padi ose procese gjyqësore me palë të treta. Drejtimi beson se cdo ngjarje e mundshme në të ardhmen nuk do të ketë efekte negative të rëndësishme në pozicionin financiar, rezultatet e aktiviteteve ose flukset monetare të kompanisë.

27. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.